



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
DREJTORIA EKONOMIKE, BURIMEVE NJERËZORE
DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RELACION

PËR MONITORIMIN 8 MUJOR TË BUXHETIT TË VITIT 2026
PËRIUDHA JANAR – GUSHT 2026

1. Hyrje

Misioni i Gjykatës Kushtetuese është garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimit përfundimtar të saj. Gjykata Kushtetuese si një organ kushtetues i pavarur kontribuon për forcimin e shtetit të së drejtës, nëpërmjet vendimmarrjes për ndërtimin e një shteti të lirë, demokratik e paqedashës, duke garantuar respektimin e të drejtave kushtetuese të çdo shtetasi, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese në konfliktin e kompetencave ndërmjet pushteteve, pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën, pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare, kushtetueshmërinë e partive, organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre.

Buxheti i akorduar për programin 03320, “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP), të hartuar gjatë procesit të PBA 2026-2028 dhe të miratuar për buxhetin e vitit 2026. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim realizimin e një procesi gjyqësor të pavarur, transparent në mbrojtje të kushtetutës dhe të drejtave themelore të njeriut nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës ndërtimore, elektronike dhe kushteve të punës të gjykatës për krijimin e kushteve optimale të punës e sigurisë për gjyqtarët dhe administratën.

Programi konsiston në mbështetjen buxhetore nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve e aktiviteteve buxhetore për mbështetjen e shërbimeve gjyqësore ndaj publikut me përmirësimin e infrastukturës së gjykatës dhe plotësimin e nevojave për mallra e shërbime.

Si pasojë e përfundimit të mandatit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit më 17 qershor 2026, referuar pikës 7 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juridiksioni disiplinor dhe ai i rivlerësimit ndaj anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë, do t'i kalojë Gjykatës Kushtetuese.

Kjo përbën një kompetencë të re kushtetuese për Gjykatën, e cila ka sjellë zgjerim të fushës së veprimtarisë së saj dhe rritje të mëtejshme të volumit të punës. Ushtrimi i kësaj kompetence kërkon administrimin dhe shqyrtimin e çështjeve disiplinore e të rivlerësimit, përgatitjen e akteve përkatëse dhe mbështetje të shtuar profesionale për procesin vendimmarrës. Aktualisht, vetëm gjatë muajit korrik 2026, rezultojnë të regjistruara 13 çështje në lidhje me këtë kompetencë të re të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, në vijim të sa u sqarua më lart, në zbatim të nenit 179/b, pika 9, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 70 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 117/2025 "Për miratimin e organikës dhe klasifikimin e pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nenit 12 të ligjit 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", pikës 58 të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026" të Ministrisë së Financave (MF), Sekretari i Përgjithshëm së bashku me punonjësit administrativë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA), për periudhën 18 qershor 2026 – 31 dhjetor 2026, kalojnë pranë Gjykatës Kushtetuese me qëllim përmbushjen e detyrave që lidhen me mbarimin e mandatit të institucioneve të rivlerësimit dhe finalizimin e procesit të mbylljes së veprimtarisë administrative të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

2. Informacion buxhetor i agreguar

Gjatë 8-mujorit të periudhës raportuese, me shkresën nr. 194 prot., datë 17.02.2026 është kërkuar çelja e fondit të veçantë në zbatim të tabelës 1, të Udhëzimit Plotësues Nr. 2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026", i cili është miratuar dhe detajuar me shkresën e MF, nr. 3270 prot., datë 20.02.2026.

Në këtë periudhë, është kërkuar edhe rialokim fondi nga llogaria 602 në llogarinë 606, në shumën 540,000 lekë për kompensimin e funksionarëve përfitues të telefonisë celulare sipas pikës 5 të Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, dhe kërkesa është miratuar me shkresën nr. 3155/1 prot, datë 27.02.2026, protokolluar në Gjykatën Kushtetuese me nr. 195/1 prot., datë 02.03.2026.

Gjithashtu, me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 10892/1 prot., datë 03.07.2026 “*Miratim transferim fondi për vitin 2026*” është miratuar transferimi i fondeve buxhetore të Kolegjit të Posaçëm të Apelit në programin buxhetor “*veprimtaria gjyqësore kushtetuese*”.

Në mënyrë të detajuar shtesat/pakësimet e buxhetit për vitin 2026 në lidhje me shpenzimet korrente, janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Në lekë

Buxheti fillestar	259,300,000
Akordim fondesh plani fillestar viti 2026 në llog 600 - Paga	182,900,000
Akordim fondesh plani fillestar viti 2026 në llog 601 - Sigurime	22,900,000
Akordim fondesh plani fillestar viti 2026 në llog 602-Shpenzime operative	45,500,000
Pakësim fondi gjatë vitit 2026 në llog 602- Shpenzime operative	-540,000
Akordim fondi shtesë gjatë vitit 2026 në llog 606 – Fond i veçantë	+ 1,247,838
Akordim fondi plani fillestar në llog 605-transferta	1,000,000
Investime kapitale për vitin 2026, llog 231	7,000,000
Transferim fondesh nga KPA në llog 600 - Paga	+ 20,158,299
Transferim fondesh nga KPA në llog 601 - Sigurime	+ 3,145,956
Transferim fondesh nga KPA në llog 602-Shpenzime operative	+ 777,376
Transferim fondesh nga KPA në llog 606 – Fond i veçantë	+ 15,513,048
Akordim fondesh me AN nr.2/2026 në llog 600 - Paga	+ 9,700,000
Buxheti pas shtesave/pakësimeve gjatë 8 mujorit të parë të vitit 2026	309,302,517

Numri i punonjësve buxhetor të Gjykatës Kushtetuese, i miratuar nga Ministria e Financave, është 73 punonjës plus 2 punonjës (specialistë) me kontratë të përkohshme pune. Numri faktik i punonjësve të Gjykatës Kushtetuese në fund të periudhës raportuese është 71+1 punonjës. (i përbërë nga 43 punonjës femra dhe 29 punonjës meshkuj).

Në zbatim të vendimit nr. 117/2025 "Për miratimin e organikës dhe klasifikimin e pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit" të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, numri i punonjësve administrativë që kalojnë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit është 28 punonjës. Numri faktik i punonjësve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në fund të periudhës raportuese është 26 punonjës. (i përbërë nga 22 punonjës femra dhe 4 punonjës meshkuj).

3. Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti

Numri i punonjësve të miratuar nga Ministria e Financave (MF) për vitin 2026 është 73 punonjës me kohë të plotë. Në fund të 8-mujorit të vitit 2026, Gjykata Kushtetuese ka 71 punonjës+1 punonjës (specialistë) me kontratë të përkohshme pune, nga të cilët 43 punonjës janë gra, ndërsa 29 punonjës janë burra.

Në pozicionet drejtuese, aktualisht Gjykata Kushtetuese ka 1 Kryetare, 3 gjyqtare femra dhe 4 gjyqtarë meshkuj, 1 Sekretar të Përgjithshëm, 1 Drejtoreshë të Kabinetit të Kryetares, 2 Drejtoresha drejtorie, 2 Drejtorë drejtorie, 7 përgjegjës sektori dhe 2 përgjegjës sektori (14 drejtuese femra dhe 9 drejtues meshkuj).

4. Performancë e buxhetit në nivel programi

Kodi i Programit: 03320

Emërtimi i programit: *"Veprimtaria gjyqësore kushtetuese"*

Qëllimet e Politikës së Programit:

Realizimi i veprimtarisë gjyqësore kushtetuese për garantimin e respektimit të Kushtetutës dhe interpretimit përfundimtar të saj, zgjidhja e mosmarrëveshjeve kushtetuese, në lidhje me ndarjen e pushteteve, ankesat e individëve, lidhur me cënimin e të drejtave kushtetuese, etj. nëpërmjet një procesi të drejtë ligjor dhe transparent.

Përshkrimi i programit: Realizimi i proceseve gjyqësore të drejta dhe transparent në mbrojtje të kushtetutës dhe lirive e të drejtave themelore të njeriut.

Veprimtaria gjyqësore kushtetuese është programi buxhetor i përbërë nga produktet:

- 93001AA** **Produkti "Vendime të marra"**, nga 550 vendime të planifikuara për vitin 2026, janë realizuar 366 vendime për periudhën 8-mujore ose në masën 67%.
- 18AG004** **Produkti "Paisje zyre"**, është i ndarë në mobilje dhe orëndi dhe paisje elektrike zyre (kondicioner, tv, etj.). Gjatë 8-mujorit të vitit 2026, ky produkt është realizuar në vlerën 749,560 lekë ose në masën 75%.
- 25AE001** **Produkti "Sistem sinjalizimi antizjarr"** është në proces prokurimi.
- 18AG003** **Produkti "Blerje pajisje informatike"** është realizuar në vlerën 3,195,750 lekë ose në masën 91%.
- 18AG102** **Produkti "Blerje librash"**, është realizuar në vlerën 265,000 lekë ose në masën 53%.

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik janë si më poshtë:

Për artikullin 600 - "Paga", me financim nga buxheti i shtetit fondi është realizuar në masën 61% për periudhën janar-gusht 2026.

Për artikullin 601 - Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, fondi i akorduar është realizuar në masën 60% për periudhën janar-gusht 2026.

Për artikullin 602 - Shpenzime operative, realizimi për këtë zë është në masën 44%.

Artikulli 605-Shpenzime për transferta korrente të huaja (605) nga 1,000,000 lekë të akorduara për vitin 2026 dhe janë shpenzuar 325,604 lekë:

1. Kuotizacioni vjetor që paguan gjykata si anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Gjykatave Kushtetuese Fronkofone (ACCF) për vitin 2026 në vlerën 229,604 lekë.
2. Kuotizacioni vjetor që paguan gjykata si anëtare me të drejta të plota në EëCCJ për vitin 2026 në vlerën 96,000 lekë.

Artikulli 606 - Shpenzime për transferta të brendshme, nga 16,760,886 lekë, janë shpenzuar 3,782,181 lekë ose në masën 23%, për rimbursimet e shpenzimeve telefonike (dhjetor 2025 - qershor 2026), pagesat kalimtare pas largimit nga funksioni për ish-kryetaren e Gjykatës Kushtetuese, si dhe ish- kryetarin dhe ish-gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit.

5. Projektet kapitale –Investime kapitale

Fondi total i akorduar nga buxheti i vitit 2026, për investimet kapitale është 7,000,000 lekë. Në këtë fond janë të përfshira investimet për të gjitha produktet e parashikuara për t'u realizuar gjatë vitit 2026 nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Këtu përfshihen investimet që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës së brendshme të gjykatës, informatizimin e veprimtarisë, pasurimin e bibliotekës me tituj profesionale, etj. Gjatë kësaj periudhe nuk janë kryer ndryshime *(rishpërndarje fondesh)*, brenda fondit të miratuar.

6. Ndryshimet në buxhet

Gjatë 8-mujorit të vitit 2026, është celur shuma 200,000 lekë në llog 606, si dhe brenda buxhetit të miratuar janë kryer rialokime, konkretisht, rialokim nga llog 602 në llog 606 në shumën 540,000 lekë.

Me Aktin Normativ nr.2/2026 janë akorduar +9,700,000 lekë në llog. 600-paga.

Gjithashtu gjatë periudhës raportuese janë transferuar fondet buxhetore të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në total 39,594,679 lekë, të detajuara si më poshtë:

Buxheti i transferuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit	Në lekë
Transferim fondesh nga KPA në llog 600 - Paga	+ 20,158,299
Transferim fondesh nga KPA në llog 601 - Sigurime	+ 3,145,956
Transferim fondesh nga KPA në llog 602-Shpenzime operative	+ 777,376
Transferim fondesh nga KPA në llog 606 – Fond i veçantë	+ 15,513,048
Total fondet e transferuara nga KPA	39,594,679

7. Përfundimet

Në përfundim të 8-mujorit të vitit 2026, realizimi i buxhetit në masën 56% reflekton një performancë të qëndrueshme financiare, si dhe një angazhim të vazhdueshëm për menaxhim profesional të fondeve publike. Gjatë periudhës janar - gusht 2026 është zbatuar monitorim sistematik i ekzekutimit buxhetor, analizë periodike e shpenzimeve dhe rishikim i vazhdueshëm i projeksioneve financiare, me qëllim garantimin e disiplinës buxhetore dhe optimizimin e përdorimit eficient të fondeve.

Në tërësi, menaxhimi financiar për periudhën raportuese vlerësohet efikas dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të financave publike. Gjatë 8-mujorit, janë evidentuar faktorë të jashtëm, të cilët ndikojnë në realizimin e procedurave të prokurimit dhe për rrjedhojë kanë ndikim edhe në realizimin e produkteve, kryesisht në investimet kapitale. Gjatë kësaj periudhe nuk janë evidentuar faktorë të jashtëm ose të brendshëm të cilët mund të kenë ndikim thelbësor në arritjen e objektivave të vendosura dhe realizimin e produkteve në përputhje me programin “Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

EUGEN PAPANDILE

